



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 443/2 Prot.

Tiranë, më 02.11.2020

**V E N D I M**  
**Nr.139, dt. 02.11.2020**

***“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të hetimit administrativ mbi gjendjen e marrëdhënieve në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë,

**VËREJ SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të shqyrtohen me prioritet rastet e individëve, pjesë e shërbimit civil në administratën qendrore dhe vendore, të cilët vazhdojnë marrëdhëniet e punës, megjithëse kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për të kryer këtë detyrë, është kërkuar nga njësitë përgjegjëse në institucionet e përfshira në këtë proces, që të raportojnë në lidhje me ata nëpunës, të cilët megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, ende vazhdojnë marrëdhënien e punës në pozicione të shërbimit civil.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si institucion i cili punëson nëpunës civil. Pas kërkesës së Komisionerit

për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 3817/1 prot., datë 05.06.2020, institucioni ka raportuar për aparatën e ministrit dhe institucionet e varësisë për punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Për aparatën e ministrit, nga analiza e informacionit të administruar pranë Komisionerit, konstatohet se, ky kusht plotësohet nga punonjësi \*\*\*\*\* (datëlindja 15.08.1959), në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Këshillimit dhe Informimit Bujqësor*”, e cila e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 15.08.2020.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në përmbajtjen e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, evidentohen në mënyrë të shprehur rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, si edhe afati dhe organi që konstaton rrethanat, si më poshtë:

“1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur:

- a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;
- b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
- c) plotësohet moshja për pensionin e plotë të pleqërisë;
- ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga:

- a) njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën;
- b) DAP-i për anëtarët e TND-së.”

Në këto kushte, plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, në rrethanat e çështjes që po shqyrtohet, është një prej rasteve që parashikohet në pikën 1/c, të kësaj dispozite dhe, për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësit ushtrojnë aktualisht detyrën, sipas pikës 2/a, të nenit të cituar më sipër, duhet të veprojë menjëherë duke e konstatuar këtë fakt, në një afat që në ligj është parashikuar 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij, si dhe duke i njoftuar ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpunësit civil \*\*\*\*\*.

Pozicioni i punës i cili do të mbetet i lirë pas këtij veprimi, duhet të shpallet vakant, për t’u plotësuar, sipas procedurës dhe kërkesave të neneve 21, 22, 23 etj., të ligjit në fjalë.

Për të gjitha sa analizuar më sipër, bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe pikës 9, të nenit 16 të rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015,

## V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, si dhe pasqyrimin e akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësen e mëposhtme:
  - \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Këshillimit dhe Informimit Bujqësor*”.
2. Pozicioni respektiv i punës, të raportohet pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicion i lirë dhe DAP të vijojë procesin për plotësimin e tij sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda **7** ditëve nga marrja dijoni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të dërgojë aktet administrative të cilat vërtetojnë realizimin e detyrave.
5. Në rast të mosrespektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe, në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohet për këtë vendim, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamenti i Administratës Publike. Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të njoftojë punonjësin për të cilin është urdhëruar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për vendimin e Komisionerit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONERI

**Pranvera Strakosha**